



FËMIJËRIA PA DHUNË, NJË E DREJTË THEMELORE

Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve – KOMF,
në partneritet me UNICEF

FËMIJËRIA PA DHUNË, NJË E DREJTË THEMELORE

Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve – KOMF, në partneritet me UNICEF

HYRJE

Me qëllim të zhvillimit të mëtejshëm të KOMF dhe anëtarëve të tij, gjatë vitit 2017 Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve në Kosovë – KOMF krijoi katër grupe punuese tematike duke synuar shkëmbim të përvojave; tejkalim të sfidave të përbashkëta; zhvillim të kapaciteteve; hartim të qëndrimeve të përbashkëta, etj.

Me qëllim të përmbushjes së këtyre synimeve, në kuadër të Grupit Tematik për Mirëqenie dhe Mbrojtje të Fëmijëve Klevis Vaqari, Ujëvara Lluga dhe Donjeta Kelmendi nga Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve – KOMF, hartuan këtë publikim mbi dukurinë e dhunës ndaj fëmijëve si një nga shkeljet më flagrante të të drejtave të tyre.

Publikimi që ju po shfletoni, përshkruan të drejtën themelore të fëmijëve për tu rritur pa dhunë dhe në një ambient të sigurtë, situatën e tyre aktuale në raport me dhunën dhe format e ndryshme të përdorimit dhe nivelin e saj, si dhe sfidat kryesore të hasura për përmirësimin e situatës. Në të njëjtën kohë, ai ofron një pasqyrë të disa prej aspekteve më të rëndësishme që duhet të merren në konsideratë gjatë zhvillimit dhe zbatimit të politikave, duke ofruar rekomandime konkrete se si duhen përmbushur këto qëllime.

Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve në Kosovë – KOMF, i themeluar në vitin 2011, është një koalicion i përbërë nga 27 organizata jo qeveritare vendore dhe ndërkombëtare të cilat punojnë në fushën e mbrojtjes së fëmijëve, me mision të përbashkët avokimin për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në Kosovë.

Organizatat anëtare të KOMF janë:

Associazione Amici dei Bambini, Asociacioni për Trajnime Sociale, Hulumtime dhe Avokim – ASTRA, Action for Mothers and Children, Balkan Sunflowers Kosova, Iniciativa 6, Kosovo Education for Sustainable Development, Kosovo Rehabilitation Center for Torture Victims KRCT, Organizata Rinore Akti, One To One Kosova – Qendra e Këshillimit për Familje, One to One Children's Fund, OPFAKKOS, Programi për të Drejtat Civile, PL4Y International, Qendra për Arsim e Kosovës – KEC, Qendra për Mbrojtjen e Viktimave dhe Parandalimin e Trafikimit me qenie njerëzore – MVPT, Qendra për Studime të Avancuara FIT, Save the Children, SOS Fshatrat e Fëmijëve Kosovë, Shpresa dhe Shtëpi për Fëmijët Kosovë, Terre des hommes, VoRAE, World Vision, The Ideas Partnership, HANDIKOS, PRAK Kosova, Childproof/ CIPOF dhe Education Comes First.

© Qëndrimi i Koalicionit të OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve - KOMF për të drejtën e fëmijëve për të jetuar një fëmijëri pa dhunë, është produkt ekskluziv i KOMF.

Ky publikim nuk reflekton domosdoshmërisht qëndrimet e donatorëve të KOMF.

PËRMBAJTJA

Përmbledhje Ekzekutive	7
Zhvillimi i fëmijës – faktorët themelor për zhvillim të shëndetshëm	9
Dhuna si një fenomen global.....	11
Abuzimi dhe mitet.....	11
Llojet e keqtrajtimit / abuzimit.....	11
Pasojat e dhunës ndaj fëmijëve	12
Mbrojtja e fëmijëve nga dhuna, në Kosovë.....	14
Infrastruktura ligjore	14
Statistikat për dhunën ndaj fëmijëve në Kosovë	16
Mjediset ku ushtrohet dhunë	16
Dhuna në familje	16
Dhuna në shkollë	16
Dhuna në komunitet	16
Dhuna si mjet disiplinimi.....	17
Ekonomia familjare / Vetëdija e ulët	17
Perceptimet dhe qëndrimet e fëmijëve rreth dhunës dhe përdorimit të saj.....	17
Identifikimi / referimi i ulët.....	18
Ofrimi i shërbimeve	19
Mbështetja financiare e kufizuar	19
Përfundime.....	21
Rekomandime	22
Referencat.....	23

SHKURTESAT

AGTSh	Anketa e Grupimeve të Treguesve të Shumëfishtë
KOMF	Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve
KDF	Konventa për të Drejtat e Fëmijës
UNICEF	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
IMF	Indeksi për Mbrojtjen e Fëmijës
QPS	Qendra për Punë Sociale
OJQ	Organizatë Jo Qeveritare
OBSH	Organizata Botërore e Shëndetësisë
PSV	Procedurat Standarde të Veprimit
LSHSF	Ligji për Shërbime Sociale dhe Familjare

*“Ne u detyrohemi fëmijëve
tanë, qytetarëve më të
cënueshëm të shoqërisë, një
jetë pa dhunë dhe frikë”.*

Nelson Mandela

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Shoqëria jonë e konsideron dhunën si një metodë që i shërben edukimit dhe disiplinimit të fëmijëve. Dhuna dhe ndëshkimi fizik i fëmijëve në Kosovë mbetet një normë sociale e pranuar dhe e aplikuar nga prindërit dhe shoqëria jonë. Konstatohet se deri në një nivel të caktuar, dhuna fizike justifikohet edhe nga vetë fëmijët, duke u parë më shumë si formë e disiplinimit.

Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës¹, 61.4 përqind e fëmijëve në Kosovë kanë konfirmuar përvojat e dhunës fizike/psikologjike brenda mjedisit familjar, gjatë muajit të fundit të intervistimit. 59 përqind e fëmijëve kishin pësuar nga dhuna psikologjike, përderisa 24 përqind e fëmijëve kishin pësuar nga ndëshkimi fizik. Rekomandohet fuqishëm vetëdijësimi në nivel nacional drejtuar popullatës së gjerë dhe institucioneve për mbrojtjen e fëmijëve, për të promovuar metodat pozitive të prindërimit dhe disiplinimit dhe për të eliminuar metodat e dhunshme të disiplinimit dhe ndëshkimit trupor.

Sipas rezultateve të dala nga Indeksi për Mbrojtjen e Fëmijës 2.0² i publikuar nga KOMF në 2018, veprimet e Kosovës për të parandaluar të gjitha format e dhunës kundër fëmijëve janë më të dukshme në ligjet dhe politikat e saj (0,823) dhe protokollet e koordinimit (0,757) nga totali prej 1.0 pikë. Kapaciteti i Kosovës është më i kufizuar me 0,400 dhe ndërtimi i shërbimeve të përshtatshme që parandalojnë, ndërhyjnë dhe mbështesin fëmijët e ekspozuar ndaj dhunës reflektohen në një rezultat prej 0,611. Llogaridhënia ndaj përfituesve, familjeve e aktorëve të tjerë është e ulët me rezultat 0,474.

Kosova, përmes Kushtetutës dhe legjislacionit vendor ka bërë përpjekje për të parandaluar veprime që mund të përkufizohen si “dhunë” ose që mund të

çojnë në dhunë, nga institucionet si shkolla, sistemi i drejtësisë apo mjediset familjare. Megjithatë, përdorimi i dhunës mbetet i lartë në këto mjedise. Rekomandohet zhvillimi i programeve të prindërimit të disiplinës pozitive për prindërit, kujdestarët dhe profesionistët që punojnë në mbrojtje të fëmijëve, për të zvogluar praktikat e dhunshme për disiplinimin dhe mirërritjen e fëmijëve, duke krijuar një brez të ri gjeneratash jo të dhunshëm.

Në anën tjetër buxheti aktual i ndarë nga qeveria dhe komunat është i pamjaftueshëm për të garantuar mbrojtje e shërbime cilësore për fëmijët që janë viktimë të formave të ndryshme të dhunës. Në përgjigje ndaj numrit të fëmijëve të cilët kanë nevojë për përkujdesje dhe shërbime, shumë qendra rezidenciale dhe qendra të kujdesit ditor që janë pjesë e sektorit jo-qeveritar ballafaqohen me sigurimin ekzistencial apo qëndrueshmërinë financiare duke rrezikuar mbylljen e këtyre shërbimeve. Në anën tjetër, Qendrat për Punë Sociale janë të mbingarkuara me raste të fëmijëve, për shkak të numrit të vogël të punëtorëve social në QPS dhe numrit të madh të fëmijëve që kanë nevojë për shërbime. Për këtë arsye, ndërhyrja është e nevojshme për të krijuar standarde financiare për shërbimet sociale dhe për të miratuar buxhetet që mundësojnë financimin e qëndrueshëm të shërbimeve të financuara përmes MPMS dhe Komunave³.

Referimet nga institucionet që punojnë me fëmijë mbeten në shkallë të ulët sidomos në rastet e dhunës në shkolla. Rekomandohet që Kosova në nivel nacional të nisë me trajnime dhe fushata vetëdijësimi për t'i përkujtuar zyrtarëve shtetëror dhe profesionistëve për detyrën e tyre për të raportuar rastet e dhunës së dyshuar ndaj fëmijëve.

Dhuna mbetet e nënraportuar edhe për shkak të hezitimit të vetë fëmijës, familjes apo bashkëmoshatarëve, për ta raportuar atë. Konsultimet me fëmijë dëshmojnë se kryesisht niveli më i lartë i informacionit të fëmijëve lidhet me dhunën fizike. Në diskutim me ta, konstatohet se deri në një nivel të caktuar, dhuna fizike justifikohet edhe nga vetë fëmijët, duke u parë më shumë si formë e disiplinimit.

Sa i përket dhunës në shkollë, fëmijët kanë pranuar ekzistencën e incidenteve të dhunës në ambientet shkollore dhe kanë renditur mësimdhënësit, bashkëmoshatarët madje edhe prindërit si ushtrues të dhunës ndaj tyre. Qëndrimi i tyre ndaj raportimit të rasteve apo ankesave, rezulton të jetë tejet skeptik. Fëmijët nuk kanë besim në efikasitetin e mekanizmave aktual të raportimit dhe ankesës, për

shkak të mos marrjes parasysh por edhe të frikës për ndonjë hakmarrje eventuale. Në anën tjetër, fëmijët kanë pak informacion për abuzimin seksual dhe për pasojat e tij, ndërsa neglizhimi mbetet nocion komplet i pa njohur për ata. Rekomandohet nxitja dhe promovimi i raportimit mes bashkëmoshatarëve dhe i vetë raportimit, përmes aktiviteteve vetëdijësuese mes fëmijëve⁴. Gjithashtu, në kuadër të rritjes së vetë raportimit dhe raportimit mes bashkëmoshatarëve, rekomandohet krijimi i një linje të re telefonike pa pagesë, të dizajnuar me dhe për fëmijët. Në anën tjetër rekomandohen aktivitete ndërgjegjësuese mbi dhunën të cilat do tu mundësonin fëmijëve të njohin llojet e dhunës duke përfshirë formën më të vrazhde të saj abuzimin seksual, dhe të shmangin situatat potencialisht të rrezikshme.

ZHVILLIMI I FËMIJËS - FAKTORËT THEMELOR PËR ZHVILLIM TË SHËNDETSHËM

Vitet e para të jetës janë tejet domethënës e të rëndësishëm për zhvillimin e fëmijës. Zhvillimi i shëndetshëm gjatë periudhës së fëmijërisë, rritja në një ambient të ngrohtë e pranues, eksperiencat pozitive dhe marrëdhëniet e qëndrueshme me personat e tjerë, janë elementë të cilët kanë ndikim të madh për vitet e mëpasshme të secilit individ, pas arritjes së moshës madhore. Gjatë këtyre viteve kritike, themeli është shëndeti fizik dhe mendor i një fëmije, i cili ndikon në gjithçka; nga jetëgjatësia në kapacitetin e përjetshëm për të mësuar, nga aftësia për t'u përshtatur në aftësinë për qëndrueshmëri kundër rrethanave negative. Mungesa e këtyre aspekteve, lë gjurmë afatgjata e shpesh të pashlyeshme, çënon vetëvlerësimin, zhvillimin mendor por edhe sjelljen e individit përgjatë gjithë jetës. Përvojat e hershme negative, p.sh. ushqimi i paqëndrueshëm, privimi i dashurisë ose edhe streset që lidhen me neglizhencën dhe keqtrajtimin, rrisin shumë gjasat e shëndetit dhe zhvillimit të dobët gjatë tërë jetës së tyre.

Faktorët kryesor që ndikojnë në zhvillimin e fëmijës, mund të grupohen në katër fusha kryesore:

■ Faktorët biologjik

Në faktorët biologjik përfshihet shëndeti i përgjithshëm i fëmijës përfshirë shëndetin fizik dhe atë mendor, elementët e trashëgimisë, praktikat dhe rutinat e shëndetshme siç janë të ushqyerit me gji, fjetja me orar, etj.

■ Faktorët mjedisor

Faktorët mjedisor lidhen me kushtet e strehimit, kushtet ekonomike të familjes dhe si e afektojnë ato fëmijën, edukimi i fëmijës i cili ndërlidhet edhe me nivelin e arsimit të prindërve, etj.

■ Marrëdhëniet ndërpersonale

Tek marrëdhëniet ndërpersonale bëjnë pjesë atashimi i sigurtë me prindin apo kujdestarin kryesor, stilet e prindërimit ndaj fëmijës siç është prindërimi autoritar, i papërfshirë etj, niveli i socializmit të fëmijës me bashkëmoshatarë dhe të rritur të tjerë, niveli i pranimi të fëmijës nga të tjerët, etj.

■ Eksperiencat e hershme

Këto eksperiencat përfshijnë përdorimet e hershme të të gjitha shqisave të fëmijës gjatë kontakteve të para me prindin apo kujdestarin.

Të gjitha sferat e përmendura më sipër, janë të rëndësishme për zhvillimin e fëmijës. Eksperiencat në fëmijëri kanë efekte të thella në gjithë procesin e të zhvilluarit të fëmijës. Megjithatë, roli i familjes si model kryesor që udhëheq rritjen dhe zhvillimin e fëmijës dhe në të njëjtën kohë ndërtimi i marrëdhënieve të sigurt e të ngrohta të fëmijës me anëtarët e familjes duke nisur prej prindërve, është thelbësor për të ardhmen e fëmijës edhe pas arritjes së moshës madhore.

Familja është mjedisi i parë dhe më i rëndësishëm për fëmijën, në të cilin krijohen përvojat e para, raportet e para sociale me persona të afërt, në rradhë të parë me prindër ose kujdestarë, e pastaj edhe me anëtarë të tjerë të familjes. Duke qenë se familja është e një rëndësie jetike për fëmijën, një mjedis i tillë që promovon dhunën si dhe rritja në kushte të tilla e në ambient ku ushtrohet dhunë, ka pasoja nga më të rëndat për vetë zhvillimin e fëmijës.

Përtej faktorit të familjes, një rëndësi të madhe kanë edhe bashkëmoshatarët, shkolla dhe komuniteti më

i gjerë. Këto aspekte mund të promovojnë raportet e shëndosha e të sigurta, pavarësimin dhe mbështetjen që ndikojnë në formimin e personalitetit të individit, ose në të kundërtën mund të ofrojnë modele të papërshtatshme si ai i dhunës dhe abuzimit, që nxit tek fëmija ndjenjën e pasigurisë, ul vetëbesimin, vetëvlerësimin dhe afekton gjithë të ardhmen e tij.

Dhuna përbën një nga format më të rënda të shkeljes së të drejtave të fëmijëve. Ekspozimi i hershëm ndaj formave të ndryshme të dhunës qoftë si viktimë apo dëshmitar i saj është kritik dhe ka një ndikim shkatërrues tek fëmija. Përtej përpjekjeve për të parandaluar format e dhunës dhe abuzimit ndaj fëmijëve, ky fenomen vijon të mbetet aktual dhe me një nevojë të menjëhershme për adresim e ndërhyrje në secilin nivel.

DHUNA SI NJË FENOMEN GLOBAL

Abuzimi dhe mitet

Faktet, të dhënat empirike por edhe raporte të ndryshme që kanë hulumtuar rreth ndëshkimit poshtërues, neglizhimit, braktisjes, dhe formave të tjera të abuzimit ndaj fëmijëve tregojnë se abuzimi i fëmijëve është një fenomen i cili ka ekzistuar në çdo kohë, duke nisur prej qytetërimeve të lashta e deri në ditët e sotme.

Përkundër miteve të shumta që e përkufizojnë abuzimin ndaj fëmijëve si fenomen që i përket një epoke të caktuar historike apo që ndodh vetëm në shoqëri apo familje të caktuara, raportet botërore rreth abuzimit dhe formave të tij, tregojnë qartë se ky është një problem shumë i madh global i cili prek secilin shoqëri pavarësisht zhvillimit të saj⁵. Ai shfaqet në forma të ndryshme dhe shpesh bazohet edhe në praktikat kulturore, ekonomike dhe shoqërore të një vendi.

Në anën tjetër, abuzimi mund të ndodhë në secilin mjedis ku fëmija zhvillon ekzistencën e tij, duke përfshirë këtu edhe ato mjedise ku ai do të duhej të ishte më i sigurt e i mbrojtur si familja, shkolla, komuniteti etj. Në një pjesë të mirë të rasteve, abuzuesit mund të jenë vetë prindërit e fëmijës apo të afërm të tjerë të tij, mund të jenë mësuesit në shkolla, profesionistët të cilët janë të mandatuar për të ofruar shërbime për ta, bashkëmoshatarët, e deri tek personat e tjerë që mund të jenë të panjohur për fëmijën.

Pavarësisht besimeve të gjithësecilit, fëmijët mund të abuzohen edhe në institucione të thirrura për të ofruar mbrojtje për ta, duke përfshirë këtu edhe organizatat jo qeveritare dhe stafin profesional që punon në ofrim

të shërbimeve për ta. Bazuar në statistikat globale, të dhënat orientojnë se fëmijët me aftësi të kufizuara janë disa herë më të rrezikuar për tu shndërruar në viktima të fomrave të ndryshme të abuzimit, duke përfshirë abuzimin seksual. Kjo ndodh për arsye të cënueshmërisë më të madhe të tyre në krahasim me fëmijët e tjerë, si edhe pamundësisë për tu arratisur nga vendngjarja, pamundësisë ose mundësisë së kufizuar për të identifikuar dhe /ose për të raportuar abuzuesin.

Një tjetër tipar karakterizues i abuzimit si fenomen global, është fakti se ai vijon të mbetet i nënraportuar për një mori arsyes. Ndër faktorët e mos raportimit të abuzimit mund të jenë pamundësia ose frika e fëmijëve për të vetë raportuar, hezitimi i familjeve për të raportuar kryesisht për shkak të stigmës në komunitet e më gjerë, mungesa e sistemit adekuat nga institucionet publike për të parandaluar dhe luftuar fenomenin si dhe ekzistenca e mentalitetit dhe traditës që e mbështet apo justifikon dhunën si mjet disiplinimi dhe edukimi i këtyre fëmijëve.

Llojet e keqtrajtimit / abuzimit

Organizata Botërore e Shëndetësisë, e përkufizon abuzimin apo keqtrajtimin e fëmijëve⁶ si: të gjitha format e abuzimit fizik dhe/ose emocional, abuzimit seksual, neglizhimit ose shfrytëzimit të formave të ndryshme, të cilat rezultojnë në dëmtim faktik apo potencial të shëndetit të fëmijës, të mbijetesës, të zhvillimit ose dinjitetit të fëmijës në kontekstin e marrëdhënies së përgjegjësisë, besimit apo fuqisë.

Në anën tjetër, OBSH ka përcaktuar edhe llojet e keqtrajtimit ndaj fëmijëve, në 4 forma të ndryshme të shprehjes së tij⁷, që janë: abuzimi fizik, abuzimi

seksual, abuzimi emocional / psikologjik dhe neglizhimi.

Abuzimi fizik

Nënkupton përdorim të forcës fizike ndaj fëmijës, që rezulton ose që ka predispozita të mëdha për të rezultuar me dëmtim të shëndetit së fëmijës, ekzistencës, zhvillimit dhe dinjitetit të tij. Këto mund të përfshijnë por nuk kufizohen në goditjet, rrahjet, gjuajtjet, shkelmimet, pickimet, shkundjet, kafshimet, shtrëngimet, djegiet, helmimin dhe ngulfatjen. Në masën e saj më të madhe, dhuna fizike ndaj fëmijëve brenda ambientit familjar, përdoret si mjet ndëshkimi.

Abuzimi emocional

Abuzimi emocional dhe psikologjik përfshin qoftë situatat/incidentet e izoluara, qoftë ato të vazhdueshme të dështimit nga ana e prindit apo kujdestarit në ofrimin dhe sigurimin e një mjedisi të përshtatshëm zhvillimor e mbështetës, përfshirë këtu mundësimin e një figure parësore për atashim me qëllim që fëmija të zhvillojë zotësi të qëndrueshme emocionale dhe sociale në përshtatje me potencialin e tij personal, dhe në kontekstin e shoqërisë ku jeton. Veprime të tilla abuzive mund të dëmtojnë shëndetin fizik apo mendor të fëmijës e gjithashtu edhe zhvillimin e tij. Këto veprime përfshijnë por nuk kufizohen në: kufizim të lëvizjes, zhvlerësim, fajësim, kërcënim, frikësim, diskriminim ose tallje, si edhe forma të tjera jo-fizike të refuzimit apo trajtimit armiqësor.

Abuzimi seksual

Abuzimi seksual është forma më e vrazhdë e abuzimit me fëmijë. Abuzimi seksual i referohet cilit do akti me natyrë seksuale që i adresohet fëmijës, nga një person i rritur, ose një fëmijë më i madh se ai. Ai përfshin por nuk kufizohet në: nxitjen apo shtrëngimin e fëmijës për të marrë pjesë në akt seksual pavarësisht përfundimit apo aprovimit të fëmijës, secilin veprim me natyrë seksual me apo pa kontakt fizik me fëmijën, me apo pa penetrim, mund të përfshijë prekjen e organeve gjenitale të fëmijës, ose detyrimin që fëmija ti prekë një më të rrituri, burrë apo grua, organet e tij/saj gjenitale, detyrimin e fëmijës për të parë materiale pornografike, angazhimi i fëmijës

ne pornografi, etj. Pasojat e abuzimit seksual mund të jenë afatgjata e të lënë gjurmë të pashlyeshme tek fëmijët.

Neglizhimi

Neglizhimi si një nga format e abuzimit të fëmijëve, është dështimi nga ana e prindërve apo kujdestarëve të fëmijës për t'i mundësuar atij / asaj plotësimin e nevojave bazë për rritje dhe zhvillim të shëndetshëm. Ai përfshin dështimin në sigurimin dhe ofrimin e kujdesit shëndetësor të posaçëm për fëmijën, supervizimin, veshmbathjen, të ushqyerit e përshtatshëm, strehimin e duhur si edhe nevojat e tjera specifike të lidhura me zhvillimin fizik, emocional, edukativ, social dhe sigurinë e fëmijës.

Pasojat e dhunës ndaj fëmijëve

Sipas hulumtimeve të ndryshme⁸, disa nga pasojat më flagrante të dhunës, ndër të tjera mund të jenë:

Vdekja e cila përbën pasojën më ekstreme të dhunës. Edhe pse zakonisht kjo mundësi nënvlerësohet, shpesh arsyeja që mund të çojë deri në vrasjes është “qëllimi për të ndëshkuar fëmijën”.

Dëmtime serioze fizike të cilat mund të shkaktohen tek fëmijët si pasojë e dhunës. Këto dëmtime mund të lënë pasojë serioze tek fëmijët në të ardhmen, duke patur parasysh se zhvillimi fizik dhe kognitiv në fëmijëri është mjaft i rëndësishëm në përcaktimin e shëndetit fizik dhe mendor të tij gjatë moshës së rritur.

Sëmundje fizike si probleme zemre, sëmundje të mushkërive ose mëlçisë, kanceri, obeziteti, etj. të cilat mund të vijnë si pasojë e formave të ndryshme të dhunës të shkaktuara ndaj fëmijëve. Këta fëmijë, janë më të prirur të vuajnë prej këtyre sëmundjeve kronike, gjatë moshës madhore.

Zhvillimi kognitiv po ashtu mund të dëmtohet rëndë tek fëmijët e abuzuar dhe të neglizhuar. Mungesa e stimuljeve pozitiv, dëmton zhvillimin e trurit të fëmijëve duke e bërë të vështirë më pas rikuperimin e tij.

PTSD ose Çrregullimi i stresit Post-Traumatik mund të shkaktohet si pasojë e përjetimit të situatave ekstreme të dhunës apo të cilat përjetojnë në vazhdimësi gjatë fëmijërisë. Gjithashtu forma të tjera të çrregullimeve si depresioni, çrregullimi i ankthit, çrregullimet e të ushqyerit etj. mund të lidhen me forma të ndryshme të dhunës ushtruar ndaj fëmijëve në fëmijëri.

Vështirësi në sjellje të cilat mund të reflektohen në vitet më pas dhe gjatë moshës madhore tek këta fëmijë. Ato mund të përfshijnë përdorimin e alkoolit, abuzimin me substanca dhe deri në përfshirje në aktivitete seksuale me rrezik të lartë. Të dhënat empirike orientojnë drejt një risku më të madh të këtyre fëmijëve për të rënë në konflikt me ligjin e për tu bërë prindër në moshë adoleshente.

Studime botërore dëshmojnë se shuplakat si pjesë e ndëshkimit trupor lidhen me agresion, sjellje antisociale, probleme të shëndetit mendor, vështirësi konjitive, vetëvlerësim të ulët dhe aspekte të tjera negative. Ky studim⁹ ka mbledhur të dhëna nga mbi 150.000 njerëz, për një periudhë mbi 50 vjeçare, dhe ka konkluduar se shuplakat nuk sjellin asnjë efekt pozitiv. Ndërkohë që janë rreth 13 probleme të shëndetit mendor që lindin e zhvillohen prej përdorimit të tyre.

Sigurisht që fëmijët kanë nevojë për disiplinë në jetën e tyre përmes vendosjes së kufinjve. Megjithatë, duhet të jemi të vetëdijshëm se ndëshkimi trupor sjell vetëm efekte negative në zhvillimin mendor afatgjatë të fëmijëve duke krijuar kështu precedentë për dhunë në të ardhmen.

Këto janë vetëm disa nga pasojat që mund të shkaktohen si rezultat i ushtrimit të dhunës ndaj fëmijëve. Fëmijët viktimë apo dëshmitarë të formave të ndryshme të dhunës, mund të përjetojnë një apo më shumë pasoja në të njëjtën kohë. Për këtë arsye, për të adresuar dhunën nevojitet një qasje holistike për të zgjidhur problemet e varfërisë, diskriminimit por dhe sjelljeve / zakoneve që rrisin mundësinë për dhunë ndaj fëmijëve.

Megjithëse pasojat e dhunës ndaj fëmijëve ndryshojnë sipas natyrës dhe ashpërsisë së saj, pasojat afatshkurtra dhe afatgjata mund të jenë shkatërruese. Ekspozimi në moshë të re ndaj akteve të dhunës ndikon ndaj ndërtimit dhe pjekjes së trurit të fëmijës më vonë. Në rast të dhunës së zgjatur, duke përfshirë rastet kur fëmijët janë dëshmitarë të dhunës, pasojat mund të çojnë në dëmtime sociale, emocionale dhe njohëse, si dhe sjellje që shkaktojnë sëmundje, lëndime dhe probleme sociale. Ekspozimi ndaj dhunës në fëmijëri mund të rezultojë gjithashtu në ndjeshmëri më të madhe ndaj dëmtimeve të përjetshme sociale, emocionale dhe njohëse, ndaj obezitetit dhe ndaj sjelljeve të rrezikut të shëndetit si abuzimi me substanca, aktiviteti i hershëm seksual dhe pirja e duhanit.

Problemet e lidhura me shëndetin mendor dhe social përfshijnë ankthin dhe çrregullimet depresive, halucinacionet, performancën e dëmtuar të punës, problemet me kujtesën, si dhe sjelljen agresive. Këto rreziqe mund të shfaqen edhe më vonë në jetë, me sëmundje të ndryshme të mushkërive, zemrës dhe mëlçisë, sëmundjeve seksualisht të transmetueshme, si dhe dhunës ndaj partnerit dhe përpjekjeve për vetëvrasje.

MBROJTJA E FËMIJËVE NGA DHUNA, NË KOSOVË

Çdo fëmijë ka të drejtën e integritetit fizik dhe personal të tij dhe të mbrojtjes nga të gjitha format e dhunës. Fëmijët, si qenie njerëzore, kanë të drejtë të gëzojnë të gjitha të drejtat e garantuara nga traktatet e ndryshme ndërkombëtare për të drejtat e njeriut të cilat janë zhvilluar nga Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut.

Shtetet kanë përgjegjësi për t'i mbrojtur fëmijët nga dhuna, abuzimi, neglizhimi si dhe për të garantuar se të drejtat e tyre mbrohen dhe respektohen. E drejta e fëmijëve për të jetuar një jetë të lirë e pa dhunë, është një e drejtë që garantohet jo vetëm përmes instrumenteve ndërkombëtare por edhe legjislacionit vendor në Kosovë, i cili është në përputhje të plotë me kërkesat e akteve juridike më të larta ndërkombëtare. Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës (KDF) është akti më i lartë ndërkombëtar i cili garanton të drejtat e fëmijëve si dhe njeh përgjegjësinë e shteteve dhe qeverive për ti mbrojtur e respektuar ato. Neni 19 i KDF¹⁰ njeh të drejtën e fëmijëve për tu rritur pa dhunë dhe në të njëjtën kohë angazhon shtetet palë për të marrë të gjitha masat e nevojshme për mbrojtjen e fëmijëve nga çdo formë e dhunës.

Infrastruktura ligjore

Edhe pse për shkak të statusit të saj politik Kosova nuk është palë ratifikuese e KDF, ajo e ka përfshirë atë përgjatë gjithë legjislacionit të saj vendor, duke nisur madje prej aktit më të lartë juridik në vend Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Neni 22 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës¹¹ garanton se marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare duke përfshirë KDF-në, janë drejtpërdrejt të zbatueshme në Kosovë, dhe në rast konflikti, kanë përparësi ndaj dispozitave ligjore dhe akteve të tjera të institucioneve

publike. Gjithashtu Neni 50 i Kushtetutës garanton që fëmijët gëzojnë të drejtën e mbrojtjes dhe të kujdesit të domosdoshëm për mirëqenien e tyre dhe se secili fëmijë gëzon të drejtën për të qenë i mbrojtur nga dhuna, keqtrajtimi dhe shfrytëzimi.

Në të njëjtën kohë dhe legjislacioni primar vendor është në linjë me parimet e KDF. Kosova ka aprovuar një sërë ligjesh të cilët prekin dhe adresojnë mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna sikurse janë;

- Ligji për Familjen e Kosovës¹²
- Ligji për Shërbime Sociale dhe Familjare¹³
- Ligji nr. 04/I-081 për Plotësimin dhe Ndryshimin e LSHSF¹⁴
- Ligji për Arsimin Parauniversitar i Republikës së Kosovës¹⁵
- Kodi i Drejtësisë për të Mitur¹⁶
- Kodi Penal i Kosovës¹⁷
- Kodi i Procedurës Penale¹⁸
- Ligji për Kujdesin Shëndetësor Emergjent¹⁹
- Ligji për Shëndetësinë²⁰
- Ligji për Mbrojtje nga Dhuna në Familje²¹
- Ligji për Parandalimin dhe luftimin e trafikimit me njerëz dhe mbrojtja e viktimave të trafikimit²²

Sipas rezultateve të dala nga Indeksi për Mbrojtjen e Fëmijës 2.0 i publikuar nga Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve – KOMF në Janar 2018, i cili është një mjet monitorues që monitoron dhe mat përpjekjet e qeverisë për të mbrojtur fëmijë në nevojë për mbrojtje institucionale, veprimet e Kosovës për të parandaluar të gjitha format e dhunës kundër fëmijëve janë më të dukshme në ligjet dhe politikat e saj (0,823) si dhe protokollet e koordinimit (0,757) nga totali prej 1.0 pikë. Kapaciteti i Kosovës është më i kufizuar me 0,400 dhe ndërtimi i shërbimeve të përshtatshme që

parandalojnë, ndërhyjnë dhe mbështesin fëmijët e ekspozuar ndaj dhunës reflektohen në një rezultat prej 0,611. Llogaridhënia ndaj përfituesve, familjeve dhe aktorëve të tjerë është e ulët me një rezultat prej 0,474. Rezultatet tregojnë për ekzistimin e një mospërputhjeje të dukshme ndërmjet shërbimeve të caktuara të Kosovës dhe kapacitetit të saj për t'i zbatuar ato në mënyrë efektive. Një boshllëk tjetër i madh është bërë i dukshëm në mes të ligjeve dhe politikave të Kosovës dhe zbatimit të këtyre zotimeve me një rezultat prej 0,336.

Ndërkohë përveç legjisllacionit primar, është hartuar dhe legjisllacioni sekondar ose dokumentet e nevojshme mbështetëse të cilat adresojnë çështjen e dhunës ndaj fëmijëve dhe udhëheqin institucionet e profesionistët mbi masat e menjëhershme që duhen ndërmarrë për të mbrojtur fëmijët nga dhuna. Ato janë:

- Procedurat Standarde të Veprimit për viktimat e trafikimit
- Procedurat Standarde të Veprimit për mbrojtje nga dhuna në familje
- Strategjia Kombëtare dhe Plani i veprimit kundër trafikimit me qenje njerëzore
- Strategjia Kombëtare dhe Plani i veprimit për mbrojtje nga dhuna në familje
- Standardet Minimale të kujdesit për viktimat e trafikimit në Kosovë
- Protokoli për Parandalimin dhe Referimin e Dhunës në Institucionet e Arsimit Parauniversitar

Përgjatë legjisllacionit të cekur më lart, vihet re se Kosova ka bërë përpjekje për të parandaluar veprime që mund të përkufizohen si “dhunë” ose që mund të çojnë në dhunë, nga institucione si shkolla, sistemi i drejtësisë apo mjediset familjare. Ligji për Arsimin Parauniversitar ndalon ndëshkimin trupor në institucionet arsimore, kurse Ligji i Familjes ndalon aktet e dhunës në mjedise familjare si dhe mundëson kufizimin ose ndalimin e të drejtave prindërore në këto raste.

Po ashtu janë hartuar Procedurat Standarte të Veprimit për kategori të caktuara. Qëllimi i tyre është krijimi i një sistemi të koordinuar të institucioneve që reagojnë menjëherë në rastet e dhunës në familje me qëllim të ofrimit të ndihmës cilësore dhe mbrojtjes së viktimës së dhunës në familje duke përfshirë rastet kur ata janë fëmijë, por duke u fokusuar në rastet e dhunës në familje e jo edhe në ato raste kur dhuna derivon nga mjedise të tjera jashtë saj.

Protokolli për parandalimin dhe referimin e dhunës në institucionet e arsimit para-universitar përcakton detyrimet, rolet dhe procedurat e institucioneve për parandalimin, identifikimin, mbledhjen e të dhënave, referimin, trajtimin, raportimin e dhunës ndaj fëmijëve, por në asnjë pjesë nuk paraqet mjetet për identifikimin e faktorëve të rrezikut dhe shenjave të dhunës dhe abuzimit seksual të fëmijëve.

Megjithë përpjekjet, korniza ligjore nuk ofron standarde financiare për të gjitha shërbimet që ofrohen apo sponsorizohen nga shteti që lidhen me parandalimin e dhunës dhe shfrytëzimit. [Prandaj rekomandohet që Kosova të ofrojë standarde financiare për të gjitha shërbimet që ofrohen apo sponsorizohen nga shteti.](#)

Po ashtu korniza ligjore nuk kërkon licencimin e detyrueshëm të shërbimeve të ofruara nga entitetet qeveritare por, kërkon licencimin e detyrueshëm të shërbimeve të ofruara nga OJQ-të/entitetet private. [Rekomandohet që për të rritur cilësinë e shërbimeve, të kërkohej licencimi i detyrueshëm i shërbimeve të ofruara nga organizatat qeveritare në bazë të kërkesave të standardeve minimale të cilësisë.](#)

Së fundmi, Kosova është në prag të finalizimit dhe aprovimit të Projektligjit për Mbrojtje të Fëmijëve, i cili nëse miratohet, do të përmirësojë qeverisjen e vendit drejt mbrojtjes së fëmijëve; ai do të konsolidojë një seri të më shumë se 14 ligjeve që rregullojnë aktorët dhe vendosin politika për fëmijët.

Statistikat për dhunën ndaj fëmijëve në Kosovë

Të dhënat e Agjencisë së Statistikave të Kosovës – ASK flasin për shifra të larta të dhunës ndaj fëmijëve në Kosovë, ku 61.4 përqind e fëmijëve në Kosovë kanë konfirmuar përvojat e dhunës fizike/psikologjike brenda mjedisit familjar, gjatë muajit të fundit të intervistimit. 59 përqind e fëmijëve kishin pësuar nga dhuna psikologjike, përderisa 24 përqind e fëmijëve kishin pësuar nga ndëshkimi fizik.

Sipas të dhënave të Policisë së Kosovës, në vitin 2017 janë raportuar gjithsej 243 fëmijë viktimë të formave të ndryshme të dhunës. Në anën tjetër, gjatë vitit 2017, MPMS ka raportuar gjithsej 225 raste të fëmijëve viktimë të formave të ndryshme të dhunës dhe abuzimit²³.

Mjediset ku ushtrohet dhunë

Save the Children²⁴ ka realizuar një hulumtim në shkolla publike, me qëllim perceptimin e prevalencës së dhunës ndaj fëmijëve, i cili është zhvilluar me 660 fëmijëve të moshës 10 – 14 vjeç, 70 arsimtar dhe 70 prindër. Rezultatet e këtij hulumtimi kanë dëshmuar se dhuna ndaj fëmijëve shtrihet në shkolla, familje dhe komunitet. Dhuna më së shumti ushtrohet në komunitet (91% e fëmijëve, 84.5% e arsimtarëve dhe 90% e prindërve), pastaj në shkollë (85.9% e fëmijëve, 40.8% e arsimtarëve dhe 88.5% e prindërve), kurse në shtëpi/familje (67.5% e fëmijëve, 63.5% e arsimtarëve dhe 85.7% e prindërve).

Në anën tjetër, hulumtimet në shkolla tregojnë grindjet mes bashkëmoshatarëve ndodhin në baza ditore dhe se këto përleshje shpesh rezultojnë me lëndime serioze. Deri në 90% të fëmijëve të intervistuar kanë deklaruar se kanë parë armë, në të shumtën e rasteve thika, në hapësirat shkollore dhe 30% e tyre kanë thënë se nuk ndihen të sigurt në shkolla. Për më shumë dhuna shokë me shokë në formë të ngacmimit, kërcënimit apo vandalizmit është gjerësisht i përhapur²⁵.

Dhuna në familje

Hulumtimet në vend tregojnë për një grup më të madh të llojeve të dhunës në familje, të cilat kanë të bëjnë me dhunë fizike, neglizhim, punë e detyruar, dhe ekspozim ndaj dhunës që ndodh në familje. Rrahja duke përdorur rrip ose ndonjë mjet tjetër të fortë, si formë e rëndë e ndëshkimit, pastaj detyrimi për të kryer punë që kanë qenë ofenduese, mungesa e ushqimit të mjaftueshëm, kryerja e punëve të rrezikshme për shëndetin, kërcënimi dhe frikësimi duke përdorur mjete të ndryshme ose armë, detyrimi për të kryer punë të rënda fizike, mungesa e mbrojtjes, kujdesit dhe përkrahjes nga familja, si dhe të shkakuarit e shenjave (mavijosje) në trup, si rezultat i përdorimit të mjeteve të forta ose armëve, janë vetëm disa nga llojet e dhunës të cilat janë raportuar në këtë nivel²⁶.

Dhuna në shkollë

Shkolla dhe institucionet edukative janë po ashtu mjedise në të cilat adoleshentët përjetojnë shpesh dhunë. Statistikat tregojnë se forma e dhunës që ushtrohet më shumë ndaj adoleshentëve ka të bëjë me dëmtimin dhe shkatërrimin e pronës, pastaj format e dhunës psikologjike dhe ato të dhunës fizike, e deri tek dhuna fizike që ka të bëjë me shtyrje, pickim, kapje për fyti. Në grupin e dytë rangohet kërcënimi dhe frikësimi me fjalë, deri tek “prekjet e ndryshme në trup për qëllime seksuale”. Dhe, në grupin e tretë janë “plaçkitja ose marrja me forcë e gjërave personale”, deri tek “sulmi seksual, ose edhe tentim dhunimi”.

Dhuna në komunitet

Format e dhunës që ndodhin më shpesh në komunitet janë ato që kanë të bëjnë me ofendimet dhe përqeshjet e ndryshme, pastaj kërcënimet dhe frikësimet e ndryshme. Dëmtimi dhe shkatërrimi i pronës, vjedhja e saj, si dhe goditjet e grushtimi i adoleshentëve. Dhuna mes bashkëmoshatarëve është gjithashtu një nga format më të përhapura të dhunës, përmes talljes, kërcënimeve, etiketimeve që i bëhen fëmijëve duke u nisur nga tipare fizike apo psikologjike të tyre, etj.

Dhuna e përdorur si mjet disiplinimi

Shoqëria jonë në një masë të madhe ende e konsideron dhunën si një metodë që i shërben edukimit dhe disiplinimit të fëmijëve, duke e justifikuar atë në këtë mënyrë. Ndërkohë që efektet negative e afatgjata që përdorimi i dhunës ka në mirëqenien e fëmijës janë anashkaluar dhe injoruar.

Shpesh vetë prindërit janë ata që mund të përdorin forma të ndryshme të dhunës si psh dhunë fizike apo emocionale. Në të njëjtën kohë ata mund edhe ta inkurajojnë atë në ambiente të tjera jashtë famijes ku fëmija kalon kohën e tij, si psh në shkollë. Edhe pse tashmë kanë nisur shumë iniciativa të cilat promovojnë stilet pozitive të prindërimit dhe edukimit të fëmijës, ende mbete shumë punë për të bërë në mënyrë që mendësia se dhuna disiplinon, të mos ekzistojë më.

Dhuna dhe ndëshkimi trupor i fëmijëve në Kosovë mbetet një normë sociale e pranuar dhe e aplikuar nga shoqëria jonë, si një mjet edukimi dhe disiplinimi për fëmijët. Kjo e gjetur bazohet edhe në rezultatet e dala nga Hulumtimi Cilësor mbi Normat Sociale lidhur me Dhunën me Bazë Gjinore dhe Ndëshkimin Fizik të Fëmijëve në Kosovë, publikuar në vitin 2016 nga UNICEF²⁷.

Të dhënat empirike dëshmojnë se dhuna në familje i zbeh marrëdhëniet e shëndosha mes prindërve e fëmijëve. Ajo gjeneron mungesë të besimit dhe mbështetjes emocionale gjatë periudhës kur fëmijët kanë nevojë të mbështeten e të besojnë te prindërit e tyre. Në të njëjtën kohë, edhe përdorimi i saj për më shumë arritje në shkollë nuk e përmirëson suksesin e fëmijës në shkollë. Përkundrazi, fëmijët që janë viktimë apo dëshmitarë të dhunës kanë rënie në mësim duke rrezikuar madje deri në braktisje të shkollimit.

Rekomandohet zhvillimi i programeve të disiplinës pozitive për prindërit, kujdestarët dhe profesionistët që punojnë në mbrojtje të fëmijëve, për të zvogluar praktikën e dhunshme për disiplinimin dhe mirërritjen e fëmijëve, duke krijuar një brez të ri gjeneratash jo të dhunshëm.

Ekonomia familjare / Vetëdija e ulët

Faktorë të tjerë që ndikojnë në rritje të probabilitetit për të ushtruar dhunë ndaj fëmijëve janë varfëria dhe niveli i ulët i edukimit në familje. Edhe rezultatet e dala nga Agjencia e Statistikave të Kosovës në Anketimin e Grupimeve të Treguesve të Shumëfishtë e reflektojnë diçka të tillë. Përtej këtyre dy aspekteve komuniteti i gjerë e pranon përdorimin e dhunës si një mjet që është i arsyeshëm dhe që i kontribuon disiplinimit dhe të mësuarit e sjelljeve të përshtatshme tek fëmijët.

Përgjithësisht, familjet me nivel më të ulët arsimor dhe ato me nivel ekonomik më të dobët, kanë më shumë të ngjarë të gjejnë ndëshkimin fizik si metodë të nevojshme për disiplinimin e fëmijëve. Sipas ASK, 11% e nënave besojnë në domosdoshmërinë e ndëshkimit fizik të fëmijëve krahasuar me 8% të baballarëve, dhe 9% të anëtarëve tjerë të rritur të familjes.

Perceptimet dhe qëndrimet e fëmijëve rreth dhunës dhe përdorimit të saj

Në kuadër të pjesëmarrjes së fëmijëve në procese që i afektojnë ata drejtpërdrejtë, KOMF ka organizuar fokus grupet me fëmijët për të marrë pikëpamjet dhe opinionet e tyre rreth fenomeneve të ndryshme, përfshirë këtu edhe dhunën ndaj fëmijëve. Rezultatet e takimeve dhe konsultimeve me fëmijë dëshmojnë se kryesisht niveli më i lartë i informacionit për të cilin fëmijët kanë informacion, lidhet me dhunën fizike, për të cilën ata janë të vetëdijshëm se nuk duhet pranuar dhe se duhet raportuar. Megjithatë, në diskutim me ta, konstatohet se deri në një nivel të caktuar, dhuna fizike justifikohet edhe nga vetë fëmijët, duke u parë më shumë si formë e disiplinimit.

Prandaj rekomandohen aktivitete ndërgjegjësuëse mbi dhunën i cili do të mundësonte fëmijëve të njohin llojet e dhunës duke përfshirë formën më të vrazhde të saj abuzimin seksual, dhe të shmangin situatat potencialisht të rrezikshme.

Sa i përket dhunës në shkolla, fëmijët kanë pranuar ekzistencën e incidenteve të dhunës në ambientet shkollore dhe kanë renditur mësimdhënësit, bashkëmoshatarët madje edhe prindërit si ushtrues të dhunës ndaj tyre. Qëndrimi i tyre ndaj raportimit të rasave apo ankesave, rezulton të jetë tejet skeptik. Fëmijët nuk kanë besim në efikasitetin e mekanizmave aktual të raportimit dhe ankesës, për shkak të mos marrjes parasysh por edhe të frikës për ndonjë hakmarrje eventuale.

Në anën tjetër, fëmijët kanë pak informacion për abuzimin seksual dhe për pasojat e tij, ndërsa neglizhimi mbetet nocion komplet i pa njohur për ata.

Fëmijët vlerësojnë se ekzistojnë lloje të ndryshme të faktorëve që shkaktojnë dhunën ndaj fëmijëve duke përfshirë video-lojërat, rrjetet sociale, prezencën e tyre në vendet ku ka dhunë. Që do të thotë fëmijët në Kosovë janë të ekspozuar në lloje të ndryshme të dhunës ku ata rrezikojnë që të kenë trauma afatgjata që sjellin ankth e ndjenjë rreziku të vazhdueshëm, që ndikon direkt në zhvillimin e fëmijës.

Vetë fëmijët, rekomandojnë organizimin e aktiviteteve të ndryshme me tema rreth dhunës dhe abuzimit ndaj fëmijëve, që ata të kenë mundësi të informohen më shumë për të drejtat e fëmijëve dhe institucionet përgjegjëse për mbrojtjen e të drejtave të tyre ku ata mund të drejtohen dhe raportojnë.

Identifikimi / referimi i ulët

Identifikimi dhe raportimi i fëmijëve në situata të dhunës është hapi i parë për mbrojtjen e fëmijëve. Korniza ligjore obligon të gjithë zyrtarët shtetërorë dhe profesionistët që kanë për detyrë të kujdesen për fëmijët në sektorët e shëndetësisë, arsimit dhe drejtësisë, të raportojnë dyshimet për dhunë në Qendrën për Punë Sociale respektive ose tek autoritetet policore të Kosovës. Por megjithatë referimet nga këto institucione mbeten në shkallë të ulët sidomos në rastet e dhunës në shkolla, përkundër faktit se mes të tjerash shkolla ka një rol domethënës edukativ me fokus në parandalim të dhunës, duke krijuar ambiente miqësore për nxënësit ku janë të mbrojtur nga: lëndimet, dhuna, presioni emocional,

parandalimit të abuzimeve, ekseseve dhe shkeljeve të të gjitha llojeve. [Rekomandohet që Kosova në nivel nacional të nisë me trajnime dhe fushata vetëdijësimi për t'i përkujtuar zyrtarëve shtetëror dhe profesionistëve për detyrën e tyre për të raportuar rastet e dhunës së dyshuar ndaj fëmijëve.](#)

Pas identifikimit dhe referimit të një rasti pranë shërbimeve sociale, menaxherët e rastit në punën sociale apo punëtorët social nga QPS, duhet të bëjnë përcjelljen e fëmijëve përmes referimit drejt shërbimeve të caktuara. Standardet minimale të Kosovës për shërbimet sociale rregullojnë numrin maksimal të rasteve që një menaxher i rasteve mund të menaxhojë në të njëjtën kohë. Megjithatë, menaxherët e rasteve brenda Qendrave për Punë Sociale janë të mbingarkuar me raste të fëmijëve, për shkak të numrit të vogël të punëtorëve social në QPS dhe numrit të madh të fëmijëve që kanë nevojë për shërbime. [Prandaj rekomandohet që Kosova të rrisë kapacitetet dhe investimet financiare në shërbimet sociale për zbatimin e politikave, ligjeve dhe rregulloreve që mbrojnë fëmijët nga dhuna.](#)

Në anën tjetër, dhuna mbetet e nënraportuar edhe për shkak të hezitimit të vetë fëmijës, familjes apo bashkëmoshatarëve, për ta raportuar atë. Shpesh janë pikërisht ndjenjat e turpit, frikës dhe stigmatizimit në familje, komunitet e shoqëri, ato që ndikojnë në numrin e ulët të referimeve të këtyre rasteve. Ky fenomen shpesh mbetet “brenda mureve të familjes” për të shmangur kështu stigmatizimin që mund ti bëhet fëmijës.

Për këtë arsye, rekomandohet nxitja dhe promovimi i raportimit mes bashkëmoshatarëve dhe i vetë raportimit, përmes aktiviteteve vetëdijësuese mes fëmijëve. Gjithashtu në kuadër të rritjes së vetë raportimit dhe raportimit mes bashkëmoshatarëve, rekomandohet krijimi i një linje të re telefonike pa pagesë, të dizajnuar me dhe për fëmijët. Shërbimi duhet të pranojë telefonatat dhe të ofrojë mbështetje, këshillim dhe krijim të rrjetit për fëmijët në situata të dhunës, abuzimit, dhe formave të tjera të shfrytëzimit.

Së fundmi, [rekomandohet vetëdijësimi i mëtejshëm në nivel kombëtar drejtuar popullatës së gjerë, për](#)

të promovuar metodat pozitive të prindërimit dhe disiplinimit dhe për të eliminuar metodat e dhunshme të disiplinimit dhe ndëshkimit trupor.

Ofrimi i shërbimeve

Kosova ka zgjedhur që shërbimet e rehabilitimit dhe re integritetit të fëmijëve viktimë të dhunës t'i ofrojnë përmes nën kontraktimit të sektorit jo qeveritar.

Institucionet e Kosovës sponsorizojnë shërbime për viktimat e dhunës që ofrohen nga OJQ të ndryshme. Megjithatë, kufizimet financiare dhe mungesa e ndarjes së një buxheti të caktuar për shërbimet sociale kufizojnë shkallën dhe kualitetin e ofrimit të këtyre shërbimeve.

Në përgjigje ndaj numrit të fëmijëve të cilët kanë nevojë për përkujdesje dhe shërbime, shumë qendra rezidenciale dhe qendra të kujdesit ditor që janë pjesë e sektorit jo-qeveritar ballafaqohen me sigurimin ekzistencial apo qëndrueshmërinë financiare duke rrezikuar mbylljen e këtyre shërbimeve.

Fëmijët që përfitojnë nga shërbimet janë të detyruar të transferohen nga një formë e kujdesit në një tjetër, gjë që përbën shkelje serioze të të drejtave të fëmijës sepse kjo mund të ketë ndikim negativ në zhvillimin fizik dhe psikologjik të tyre²⁸.

Fëmijët viktimë të formave të ndryshme të dhunës, janë fëmijët më të cënueshëm. Sipas legjislacionit në fuqi shteti duhet të garantojë mbrojtjen për këta fëmijë. [Rekomandohet që MPMS dhe Komunitatet për sigurojnë buxhet të qëndrueshëm për të garantuar të drejtën e fëmijës për mbrojtje, e drejtë kjo e garantuar me Konventën për të Drejtat e Fëmijës, Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe legjislacionin vendor në fuqi.](#)

Mbështetja financiare e kufizuar

Në vitin 2016, buxheti i MPMS për subvencione dhe transfere ka qenë 351,311,674 € përkatësisht 97,7% e buxhetit total të kësaj ministrie, ku këtu hynë skemat pensionale, skemat për mbrojtjen e kategorive të dala nga lufta, skema për minatorët e Trepqës, etj.

MPMS përmes procesit të thirrjeve publike, ka vazhduar të mbështesë ofrimin e shërbimeve direkte të ofruara nga sektori jo qeveritar. Shuma maksimale e mbështetjes financiare me subvencione, për një OJQ e cila ofron shërbime mund të jetë deri në 10,000-40,000 euro për projekt (regjional apo nacional). Kohëzgjatja për zbatimin e aktiviteteve të projekt propozimit është dhjetë (10) muaj.

Megjithatë, kjo mbështetje rezulton të jetë e pamjaftueshme duke patur parasysh koston e shërbimeve të ofruara. Kostoja mesatare e një fëmije për qëndrim vjetor në kujdes rezidencial është 7,500 EUR që përfshinë banimin, ushqimin bazë, dhe përkujdesjen profesionale institucionale. Në anën tjetër, Komunitatet nuk publikojnë thirrje për financimin e shërbimeve të ofruara nga sektori jo qeveritar. Mbështetja e komuniteteve mbetet ad hoc dhe varion nga komuna në komunë. Ka komuna të cilat fare nuk ndajnë buxhet dhe nuk mbështesin shërbimet sociale të ofruara nga sektori jo qeveritar, për dallim prej disa komuniteteve të cilat ndajnë shuma simbolike vjetore 500 - 10,000 Euro të cilat nuk garantojnë qëndrueshmëri dhe as cilësi të shërbimeve.

Niveli aktual i financimit komunal nuk plotëson as për së afërmi nevojat të cilat këto shërbime kërkojnë për të qenë në nivelin optimal të funksionimit. Megjithatë një numër i komuniteteve ka ndarë kohë pas kohe shuma të caktuara parash për të mbajtur gjallë këto shërbime në momente të caktuara kur këto shërbime kanë rrezikuar të mbyllën. Nëse vazhdohej me këtë formë të financimit gjendja mund të keqësohet për aq sa ta sjellë Qendrat për Punë Sociale dhe organizatat jo qeveritare në jofunksionale, e në rastet e tjera në qendra dhe organizata me performancë më të ulët ose nuk do të mund të ofrojnë shërbime të tilla.

Në situatën e rëndë në të cilën ndodhen shërbimet sociale, ku akoma nuk është bërë kufizimi i shërbimeve (standartet financiare) dhe nuk është krijuar plani për financim të qëndrueshëm të shërbimeve sociale nga MPMS dhe Komunitatet, është e domdoshme që të intervenohet nga të dy nivelet: qendror dhe komunal (MPMS dhe Komunitatet) deri në sigurimin e një zgjidhjeje të qëndrueshme të financimit të shërbimeve sociale.

Pragu i minimumit të financimit për shërbimet sociale direkte të ofruara nga sektori jo qeveritar të rritet nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, në mënyrë që të mundësohet vazhdimi i ofrimit të shërbimeve për fëmijët e cenueshëm dhe ne anën tjetër të elimonohen zbrazëtitë e krijuara kohore mes thirrjeve për financim të shërbimeve nga MPMS. Komunat të

ndërmarrin të gjitha masat për të siguruar financimin e shërbimeve sociale direkte brenda komunës së tyre, të lidhin kontrata me organizatat jo-qeveritare të licencuara dhe të dëshmuara me përvojën dhe profesionalizimin e tyre në ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare, në emër të komunës.

PËRFUNDIME

- Shoqëria jonë në Kosovë e konsideron dhunën si një metodë që i shërben edukimit dhe disiplinimit të fëmijëve. Dhuna dhe ndëshkimi fizik i fëmijëve në Kosovë mbetet një normë sociale e pranuar dhe e aplikuar nga shoqëria jonë. Në diskutim me fëmijët, konstatohet se deri në një nivel të caktuar, dhuna fizike justifikohet edhe nga vetë fëmijët, duke u parë më shumë si formë e disiplinimit.
- Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës, 61.4 përqind e fëmijëve në Kosovë kanë konfirmuar përvojat e dhunës fizike/psikologjike brenda mjedisit familjar, gjatë muajit të fundit të intervistimit. 59 përqind e fëmijëve kishin pësuar nga dhuna psikologjike, përderisa 24 përqind e fëmijëve kishin pësuar nga ndëshkimi fizik.
- Sipas Indeksit për Mbrojtjen e Fëmijës 2.0 i publikuar nga KOMF në 2018, veprimet e Kosovës për të parandaluar të gjitha format e dhunës kundër fëmijëve janë më të dukshme në ligjet dhe politikat e saj (0,823) si dhe protokollet e koordinimit (0,757) nga totali prej 1.0 pikë. Kapaciteti i Kosovës është më i kufizuar me 0,400 dhe ndërtimi i shërbimeve të përshtatshme që parandalojnë, ndërhyjnë dhe mbështesin fëmijët e ekspozuar ndaj dhunës reflektohen në një rezultat prej 0,611. Llogaridhënia ndaj përfituesve, familjeve dhe aktorëve të tjerë është e ulët me një rezultat prej 0,474.
- Referimet nga institucionet që punojnë me fëmijë mbeten në shkallë të ulët sidomos në rastet e dhunës në shkolla. Dhuna mbetet e nënraportuar edhe për shkak të hezitimit të vetë fëmijës, familjes apo bashkëmoshatarëve, për ta raportuar atë.
- Sa i përket dhunës në shkolla, fëmijët kanë pranuar ekzistencën e incidenteve të dhunës në ambientet shkollore dhe kanë renditur mësimdhënësit, bashkëmoshatarët madje edhe prindërit si ushtrues të dhunës ndaj tyre. Qëndrimi i tyre ndaj raportimit të rasteve apo ankesave, rezulton të jetë tejet skeptik. Fëmijët nuk kanë besim në efikasitetin e mekanizmave aktual të raportimit dhe ankesës, për shkak të mos marrjes parasysh por edhe të frikës për ndonjë hakmarrje eventuale.
- Konsultimet me fëmijë dëshmojnë se kryesisht niveli më i lartë i informacionit të fëmijëve lidhet me dhunën fizike. Fëmijët kanë pak informacion për abuzimin seksual dhe për pasojat e tij, ndërsa neglizhimi mbetet nocion komplet i pa njohur për ata.

REKOMANDIME

- Rekomandohet fuqishëm vetëdijësimi në nivel nacional drejtuar popullatës së gjerë dhe institucioneve për mbrojtjen e fëmijëve, për të promovuar metodat pozitive të prindërimit dhe disiplinimit dhe për të eliminuar metodat e dhunshme të disiplinimit dhe ndëshkimit trupor.
- Rekomandohet që Kosova në nivel nacional të nisë me trajnime dhe fushata vetëdijësimi për t'i përkujtuar zyrtarëve shtetëror dhe profesionistëve për detyrën e tyre për të raportuar rastet e dhunës së dyshuar ndaj fëmijëve.
- Zhvillimi i programeve të prindërimit të disiplinës pozitive për prindërit, kujdestarët dhe profesionistët që punojnë në mbrojtje të fëmijëve, për të zvogluar praktikën e dhunshme për disiplinimin dhe mirërritjen e fëmijëve, duke krijuar një brez të ri gjeneratash jo të dhunshëm.
- Fuqizimi i zbatimit të politikave dhe ligjeve për mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna. Ofrimi i shërbimeve dhe mbështetjes për fëmijët viktimë të dhunës dhe familjeve të tyre, si dhe ndëshkimi i kryrësve të dhunës. Shërbime të tilla ndihmojnë fëmijët të përballen me situatën e tyre, dhe gjithashtu të thyejnë ciklin e abuzimit dhe të zvogëlojnë dëmin e mëtejshëm.
- Rekomandohet nxitja dhe promovimi i raportimit mes bashkëmoshatarëve dhe i vetë raportimit, përmes aktiviteteve vetëdijësuese mes fëmijëve. Gjithashtu në kuadër të rritjes së vetë raportimit dhe raportimit mes bashkëmoshatarëve, rekomandohet krijimi i një linje të re telefonike pa pagesë, të dizajnuar me dhe për fëmijët. Në anën tjetër rekomandohen aktivitete ndërgjegjësuese mbi dhunën të cilat do të mundësonin fëmijëve të njohin llojet e dhunës duke përfshirë formën më të vrazhde të saj abuzimin seksual, dhe të shmangin situatat potencialisht të rrezikshme.
- Rekomandohet krijimi i standardeve financiare për shërbimet sociale dhe për të miratuar buxhetet që mundësojnë financimin e qëndrueshëm të shërbimeve të financuara përmes MPMS dhe Komunave.
- Rekomandohet ndalimi i ndëshkimit trupor me ligj, në të gjitha ambientet ku fëmija zhvillon ekzistencën e tij.

REFERENCAT

- 1 Agjencia e Statistikave të Kosovës; Anketa e grupeve të Treguesve të Shumëfishtë; 2014; <http://ask.rks-gov.net/media/1879/monitorimi-i-situat%C3%ABs-s%C3%AB-f%C3%ABmij%C3%ABve-dhe-femrave.pdf>
- 2 Indeksi identifikon boshllëqet ndërmjet politikave dhe zbatimit / implementimit, duke dokumentuar faktet nga terreni. Indeksi përbëhet nga 987 indikatorë që masin politikat dhe veprimet e shtetit për të mbrojtur dhe për t'u kujdesur për fëmijët nën juridiksionin e tyre. Korniza e indikatorëve të Indeksit mbështetet fuqimisht në Doracakun e Zbatimit të Konventës për të Drejtat e Fëmijës, publikuar nga UNICEF. Indeksi përdor këto lista kontrolli si indikatorë kyç për matje të performancës së shtetit përmes pesë fushave/dimensioneve: politikat dhe ligji, shërbimet, kapacitetet, koordinimi dhe llogaridhënia. Përmes sistemit të pikësimit, Indeksi nxjerr rezultatet e përpjekjeve të qeverisë nga 0 deri në 1 pikë. Sa më i ulët të jetë rezultati, aq më i dobët është veprimi i ndërmarrë; sa më i lartë të jetë rezultati, aq më i fuqishëm është veprimi i ndërmarrë për fëmijët.
- 3 Financimi i Shërbimeve Sociale në Kosovë KOMF 2017; <http://www.komfkosova.org/wp-content/uploads/2017/05/Financimi-i-sherbimeve-sociale.pdf>
- 4 Indeksi i Mbrojtjes së Fëmijës 2.0; faqe 14; <http://www.komfkosova.org/wp-content/uploads/2018/01/Raporti-shqip.pdf>
- 5 [https://www.unicef.org/lac/full_text\(3\).pdf](https://www.unicef.org/lac/full_text(3).pdf)
- 6 Report of the consultation on child abuse prevention, 29–31 March 1999. Geneva, World Health Organization, 1999 (document WHO/HSC/PVI/99.1). file:///C:/Users/Admin/Downloads/ËHO_HSC_PVI_99.1.pdf
- 7 World Health Organization and International Society for Prevention of Child Abuse and Neglect (2006). "1. The nature and consequences of child maltreatment". *Preventing child maltreatment: a guide to taking action and generating evidence* (PDF). Geneva, Switzerland. ISBN 9241594365.
- 8 <https://childhub.org/sq/online-biblioteka-o-djecijoj-zastiti/pasojat-e-dhunes-ndaj-femijeve-rishikim-nga-child-hub>
- 9 <http://www.ilovenature.world/i-love-nature-news/2016/5/31/results-of-a-50-year-study-show-that-spanking-has-significantly-negative-effect-on-childrens-mental-health>
- 10 Konventa për të Drejtat e Fëmijës; [https://www.unicef.org/tfymacedonia/CRC_albanian_language_version\(3\).pdf](https://www.unicef.org/tfymacedonia/CRC_albanian_language_version(3).pdf)
- 11 Kushtetuta e Republikës së Kosovës; <http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Kushtetuta.e.Republikes.se.Kosoves.pdf>
- 12 http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2004_32_al.pdf
- 13 http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2005_02-L17_al.pdf
- 14 <http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/Ligji%20per%20ndrysh%20e%20Ligjit%20per%20sherbime%20sociale%20dhe%20familjare.pdf>
- 15 <http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/04-L-032%20sh.pdf>
- 16 <http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2010-193-alb.pdf>
- 17 <http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/Kodi%20penal.pdf>
- 18 <http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/Kodi%20i%20procedures%20penale.pdf>
- 19 http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2006_02-L50_al.pdf
- 20 http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2004_4_al.pdf
- 21 <http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2010-182-alb.pdf>
- 22 <http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/Ligji%20per%20parandalimin%20dhe%20luftimin%20e%20trafikimit%20me%20njerez.pdf>
- 23 KOMF-Raportet e gjashtë mujorit nga Policia e dhunës në familje dhe MPMS; 2017
- 24 Krasniqi, V. & Osmani, T. (2012). Research on Violence against Children in Schools in Kosovo. Prishtinë. Save the Children. Raport i pa publikuar
- 25 Iniciativa Kosovare për Stabilitet IKS; Raport mbi dhunën ndaj fëmijëve në shkolla; 2013; http://iksweb.org/wp-content/uploads/2013/12/IKS_Dhuna_ne_shkolle_2013_923341.pdf
- 26 <http://www.doktoratura.unitir.edu.al/wp-content/uploads/2017/09/Doktoratura-Armen-Mustafa-Fakulteti-i-Shkencave-Sociale.pdf>
- 27 https://www.unicef.org/kosovoprogramme/FINAL_SHQIP_Social_Norms_on_GBV_DV.pdf
- 28 Financimi i shërbimeve sociale në Kosovë 2017, KOMF; <http://www.komfkosova.org/wp-content/uploads/2017/05/Financimi-i-sherbimeve-sociale.pdf>

Publikuar nga:

Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve – KOMF
Zenel Salihu, OB.1 HY.1 K.3No.16,
10000 Prishtinë,
Kosovë 2017

+ 381 38 220 287
www.komfkosova.org



Rr. Zenel Salihu, OB.1 HY.1 K.3
No.16, 10000 Prishtinë, Kosovë



Tel: +381 (0) 38 220 287



info@komfkosova.org



www.komfkosova.org